

TRASHËGIMIA KULTURORE E QARKUT KORÇË

Qarku i Korçës ka një potencial të lartë të trashëgimisë kulturore.

Ajo përfaqësohet nga:

- **trashëgimia kulturore materiale** (monumentet arkeologjike, arkitektonike, të kultit, etnografike, etj)
- **trashëgimia kulturore shpirtërore** (folklori, këngët, vallet, zejet, festat, gastronomia, etj).

Vlerat e trashëgimisë kulturore materiale

Trashëgimia kulturore materiale përfaqëson një bashkësi vlerash kulturore dhe historike të trashëguara, të shprehura përmes tipologjive të ndryshme arkeologjike arkitekturore, historike, artistike etj. Në qarkun e Korçës, si pjesë e trashëgimise kombëtare ndodhen 158 objekte kulturore, që për nga vlerat e tyre gëzojnë statusin ligjor të monumentit të kulturës. Këto evidentohen si vendbanime arkeologjike, kala, varre monumentale, banesa, ura, objekte kulti etj. Krahas këtyre, ndodhen edhe objekte të tjera, që ndonëse kanë vlera kulturore me rëndësi 166 kombëtare, nuk mbrohen me status të veçantë. Sipas përcaktimeve të dhëna për trashëgimisë kulturore materiale.

Monumentet e kulturës materiale në qarkun e Korçës klasifikohen në:

•Monumente arkeologjike

Në monumentet arkeologjike përfshihen vendbanimet arkeologjike të llojeve të ndryshme, objekte, dhe elementë të tjerë ndërtimesh me vlera arkeologjike, arkitekturore, historike dhe kulturore që janë rezultat i gërmimeve arkeologjike. Gërmimet arkeologjike të shoqëruara me vëzhgimet në terren, kanë provuar se territoret e Shqipërisë Juglindore (*Korça, Kolonja, Pogradeci dhe Devolli*), kanë patur një kulturë shumë të zhvilluar në të gjitha epokat historike (prehistori, antikitet dhe mesjetë). Megjithë praninë e një numri të madh të objekteve arkeologjike, kryesisht rrënoja, do të ndalemi në veçanti, në ato të cilat përbëjnë ose ofrojnë mundësi për t'u shndërruar në atraksione turistike; vendbanime, fortifikime (kala) dhe vendvarrime, që krahas vlerave arkeologjike, shkencore, edukative mbartin vlera të rëndësishme turistike.

➤ **Vendbanimet (kalatë, kështjellat, shpellat)**

Vendbanimi i Kamnikut në rrethin e Kolonjës përbën vendbanimin më të hershëm të fortifikuar, i ndërtuar me ledhe guri¹⁰⁷. Rëndësia e vendbanimit të datuar nga studjuesit rreth viteve 2800-2700 p.e.s.¹⁰⁸ evidentohet më së miri nëpërmjet gjetjeve arkeologjike me vlera të rëndësishme shkencore, kulturore dhe turistike të ekspozuara në muzeun e qytetit të Ersekës.

Vendbanimi prehistorik i Maliqit (palafit) i zbuluar pranë qytetit të Maliqit, përfaqëson kulturën më të zhvilluar të vendbanimeve prehistorike shqiptare të periudhave të Neolitit të vonë, Bakrit dhe Bronxit¹⁰⁹. Banesat në këtë vendbanim kanë genë ndërtuar në një platformë druri, të vendosura mbi trarë të ngulur në tokë¹¹⁰. Ky vendbanim i përket periudhës së neolitit rreth viteve 2600 p.e.s.¹¹¹. Qeramika që lidhet me epokën e bronxit dhe që është pagëzuar nga studjuesit me emrin “devollite”, përfaqëson një nga arritjet më të mira të artit dekorativ të epokës së bronxit. Materialet e gjetura (enë të ndryshme, vegla pune prej bakri dhe bronxi) paraqesin vlera shkencore, arkeologjike, kulturore, historike, edukative dhe turistike dhe së bashku me maketin e vendbanimit ndodhen të ekspozuara në Muzeun Arkeologjik të qytetit të Korçës.

Megjithëse aktualisht i pa vizitueshëm, përshtatja dhe improvizimi i banesave prej druri në këtë vendbanim, do t'a shndërronin atë në një zonë arkeologjike turistike me mjaft interes për turistët e huaj. Një rast jo aq i ngjashëm nga vlerat dhe rëndësia me vendbanimin prehistorik të Maliqit, por që është shndërruar në një atraksion turistik, është muzeu i vendbanimit palafit, Bay of Bones Museum (1200-700 p.e.s) i ngritur në liqenin e Ohrit, pranë qytetit të Ohrit në FYROM. Po kështu një atraksion turistik përbën edhe vendbanimi neolitik bregliqenor, në fshatin Dispilio 8 km larg nga qyteti i Kosturit në Greqi, i vizitueshëm nga turistët ndërkombëtarë.

Vlerat e trashëgimisë arkeologjike dëshmojnë gjithashtu me praninë e vendbanimeve të fortifikura që i përkasin fazës së parë të epokës së hekurit. Kësaj periudhe i përkasin fortifikimet e Gradishtës së Shuecit, Trenit, Ventrokut, Bilishtit, Kakaçit, Gjonomadhit, Lumalasit, Bellovodës, Trajanit, muri pengues i Zvezdës, Podgorisë në Korçë dhe kalaja e Gradecit, Bejkovës, Hollmit, Barmashit, Gradec i Vrepckës dhe muri pengues porta e hekurit (Kolonjë). Në vështrimin e përgjithshëm, ndonëse këto fortifikime ruhen në formë përgjithësisht të mirë, nëpërmjet gjetjeve në to, nxjerrin në pah aspekte të zhvillimit social-ekonomik që ka karakterizuar gjithë zonën.

Një zonë të rëndësishme ku ndërthuren vlerat natyrore me vlerat arkeologjike përbën *zona e liqenit të Prespës së Vogël*, e cila për nga interesi që paraqet për turistët e huaj mund të konsiderohet si zonë turistike. Disa nga objektet arkeologjike që ndodhen këtu përmendim: Gradishtën e Shuecit në trajtën e një ledhi gurësh në kodrën buzë liqenit dhe kalanë e Ventrokut mbi shpellën e Trenit, të përcaktuara nga arkeologët, si të vetmet fortifikime të këtij lloji të zbuluara në vendin tonë, të ndërtuara në pika me karakter mbrojtës dhe strategjik.

Kalaja e Trajanit, më e madhja ndër të gjitha kalatë e njohura brenda vendit tonë, rrethon një sipërfaqe 22 ha, në lartësinë 1245 m mbi nivelin e detit. Ndodhet në trajtë linje muresh taracimi dhe ndonëse në të nuk janë kryer gërmime arkeologjike, ajo paraqet një qendër të rëndësishme paraurbane për pellgun e Korçës e më gjerë.

Nëpërmjeturvejimeve sipërfaqësore shumëvjeçare është bërë e njohur gjithashtu

piktura shkëmbore e Spilesë, e ndodhur 500 m larg shpellës së Trenit, në faqen shkëmbore të masivit që zbrit në bregun e liqenit të Prespës së Vogël. Vlerat kulturore dhe artistike trasmetohen në pikturën e gdhendur në shkëmb, nëpërmjet një skene gjuetie me figura kalorësish mbi kuaj, drerë dhe zagarë.

Shpella e Trenit ndodhet në vendin që njihet si “gryka e ujkut”, buzë liqenit të Prespës së Vogël dhe është një kombinim i rrallë i vlerave natyrore me vlerat materialo-shpirtërore. Është formuar nga procesi i karstit, nga tretja në ujë e shkëmbinjve gëlqerorë mesozoikë, tepër të copëtuar nga shkëputje tektonike të plio-kuaternarit. Sipas spelologëve që eksploran shpellën ajo ka dy hyrje, hyrjen kryesore me lartësi 30 m dhe një hyrjen dytësore rreth 4 m mbi kryesoren. Gjatësia e përgjithshme e saj është 293 m dhe përbëhet nga pesë “salla”, me përmasa të ndryshme. Vlerave natyrore u bashkangjiten edhe vlerat kulturore, pasi shpella ka shërbyer si vendbanim për njerëzit e lashtë që kanë jetuar në zonën juglindore të Shqipërisë. Nga gjetjet e zbuluara prej arkeologëve (prej guri, stralli, kocke, bronxi, hekuri e argjendi) veçanërisht të atyre prej qeramike dëshmohet se banorët e kësaj shpelle krahas bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit kanë qenë mjeshtër në punimin dhe zbulimin e qeramikës. Në brendësi të saj ndodhen konkelacione stalaktitesh dhe stalakmitesh mjaft interesante.

Gjithashtu *shpella* është vendbanimi i një kolonie lakuriqësh që ndodhen në të. Megjithëse me vlera të rëndësishme shkencore dhe turistike, është e rrezikuar për shkak të dëmtimeve nga mosnjohja e vlerave të saj nga banorët, por edhe nga prania e aktiviteteve të guroveve që kërcënojnë shembjen e pjesëve të brendshme. Të gjitha këto vendbanime të fortifikuara e shpellore, së bashku me “Goricat e Trenit”, “Pavliqet” etj., të cilat ndodhen pranë Shpellës së Trenit, përbëjnë një kompleks kulturor, që ruan mbetje sipërfaqësore i ndërthurur me mjedise gjeografike me bukuri të rrallë natyrore¹²⁰ (brenda parkut ndërkufitar të Prespës). Ato kanë nevojë të eksplorohehen, studiohehen dhe integrohen realisht në planet e menaxhimit të parkut dhe projektet konkrete, që po ndërmerren nga organizmat shtetërore dhe ndërkombëtare. Kjo do ndikonte në rritjen e numrit të turistëve dhe nëpërmjet kësaj do të krijoheshin mundësitë për zhvillimin e komunitetit që jeton në këtë zonë. Ideja e shndërrimit të shpellës së Trenit në një muze të vizitueshëm, megjithëse kërkon investime të shumta, mbetet një mundësi reale. Po kështu, kthimi i zonës në park arkeologjik do të ndihmonte në ruajtjen e këtyre vlerave, por njëkohësisht do të rriste interesin e vizitorëve e huaj në zonë.

Treva e Kolonjës përmban gjithashtu potenciale të shumta arkeologjike si kalaja e Luarasit (periudha e Bronzit të vonë); kalaja e Hollmit në trajtë rrethimesh guri, që e datojnë në fazën e dytë të epokës së hekurit dhe në vijimësi gjatë periudhës Qytetare Romake shek.I-III, pas Krishtit¹²²; kalaja e Bejkovës ndodhet mbi një rën nga majat e vargut kodrinor (1080 m mbi nivelin e detit) që datohet në fundin e epokës së bronzit deri në periudhën e hekurit të hershëm (shek.XI-IX, parakrishtit)¹²³; kalaja e Gradecit (Vrëpckë) me tipare krejt të veçanta e cila daton në periudhën qytetare ilire (shek.VIV para Krishtit.

Në **treven e Pogradecit**, *kështjella e Pogradecit* është dëshmi e zhvillimit të pandërprerë të vendbanimit, për periudha të rëndësishme historike. Fragmentet e

qeramikës të identifikuara si prodhim vendas ilir, kanë treguar si periudhën më të hershme të banimit në kështjellën e Pogradecit (gjysma e shek. e V dhe fillimi dhe fillimin e shek.IV p.e.s)¹²⁵. Larmia e fragmenteve të qeramikës vendase (enët e baltës, tasa, kupa, kantarë, pitosat, monedhat) dhe asaj të importuar, nxjerr në pah se banorët janë marrë me bujqësi, peshkim e zeje të ndryshme dhe kanë pasur marrëdhënie me vendbanimet fqinje. Pas zhvillimeve të vazhdueshme (shek. IV- VIII e.s) dëshmohet nga studiuesit të jetë periudha e katërt dhe e fundit e banimit në kështjellën e Pogradecit¹²⁶. Sipas studjuesve mendohet që kështjella të jetë rrënuar gjatë pushtimit bullgar. Ndonëse në gjendje të rrënuar, kështjella e Pogradecit së bashku me bazilikën e Linit, varret monumentale të Selcës dhe kategori të tjera të monumenteve të kulturës, përbëjnë një ofertë të trashëgimisë kulturore me mjaft interes në zhvillimin e sektorit turistik.

➤ **Vendvarrimet (tumat)**

Tumat, (vendvarrimet) ashtu sikurse vendbanimet dhe fortifikimet janë elementë të rëndësishëm të trashëgimisë arkeologjike me mjaft interes në aspektin turistik. Nga studimet e bëra nga arkeologët rezultoi se zona e Korçës dhe Kolonjës është e pasur me këtë lloj trashëgimie (tumat e Barçit dhe Kuçit të zi, tumat e Prodanit, Rehovës, Shtikës dhe tuma e Kamenicës). Me studimet e tyre arkeologët, krahas të tjerave evidentojnë edhe një pjesë e rëndësishme e organizmit social të komuniteteve prehistorike, që lidhet me zakonet mortore dhe ritet e varrimit.

Tuma e Kamenicës, ndodhet në ekstremin juglindor të fushëgropës së Korçës, në territorin e komunës Mollaj. Gërmimet e bëra nga arkeologët në vitin 2002, kanë zbuluar një vendvarrim me përmasa më të mëdha se vendvarrimet e zbuluara më parë. Fillimet e saj datojnë në fazën fundore të periudhës së Bronzit të vonë (rreth 1250-1050/1025 B.C). Aty janë zbuluar rreth 400 varre dhe mbetje skeletore të më shumë se 430 individëve¹²⁹. Interes paraqet mënyra në trajtimin e të vdekurve dhe rasti i vendosjes së dy individëve në të njëjtin varr. Interesante paraqitet gjithashtu gjetja e skeletit të trupit të një gruaje dhe një fëmije në barkun e saj. Kjo tumë është shëndërruar në një atraksion turistik të vizituar nga grupe të ndryshme vizitorësh. Vendvarrimi prehistorik është i përshtatur sipas kriterëve bashkohore të zonave arkeologjike dhe është transformuar në një qendër të rëndësishme të informimit dhe edukimit arkeologjik. Në muzeun e tumës janë të ekspozuara larmi enësh qeramike të pikturuara dhe objekte të tjera metalike (prej bronxi, hekuri, ari, kocke, qelqi apo guri, të cilat dëshmojnë qartë për organizmit social-ekonomik dhe kulturor të komunitetit prehistorik të zonës. Ajo vizitohet në mënyrë të organizuar nga nxënës të shkollave, studentë, vizitorë vendas dhe të huaj. Vizitat janë kundra pagesës prej 50 lekë për studentët dhe nxënësit dhe 200 lekë për vizitorët e tjerë. Me mjaft interes për t'u vlerësuar paraqiten grupet e studentëve të huaj nga gjithë bota, të apasionuar në këtë kategori të trashëgimisë kulturore.

Tuma e Rehovës e zbuluar nga gërmimet arkeologjike (1979-1980) në rrethin e Kolonjës, përbën një tjetër objekt arkeologjik me vlera të rëndësishme edukative dhe turistike. Nga gërmimet arkeologjike krahas 285 varre janë zbuluar 650 objekte me përkatësi kohore të ndryshme (Bronxi i vonë deri Mesjetën e hershme). Gjetjet e objekteve në varre përbëhen nga: qeramikë, armë bronxi e hekuri dhe disa stoli prej

bronxi, hekuri, argjendi, floriri, kocke, guri, qelibari etj. Këto objekte iliro-arbërore janë ekspozuar në muzeun e Rehovës.

- **Monumentet arkitekturore**

Monumentet arkitekturore janë pjesë e pasurisë kulturore që ruajnë vlera të veçanta të konceptimit dhe realizimit arkitekturor dhe artistik. Vendbanimet lakustre apo palafite të zbuluara në Maliq dhe Dunavec, janë monumentet më të hershme, që shënojnë fillimet e arkitekturës në vendin tone.

Larmia e ndërtesave të trashëguara është një element i rëndësishëm, që pasqyron zhvillimin social-ekonomik të komunitetit dhe zonës në periudha të ndryshme kohore.

- *Varret monumentale*

Shprehjen e kësaj kategorie të trashëgimisë e përbëjnë *Varret monumentale të Selcës* si element karakteristik i qytetit ilir në Selcën e Poshtme. Nga gërmimet e bëra në vitet 1970-1972 u zbuluan 4 varre monumentale të grupuara në dy zona, 100 m larg nga njëra-tjetra, që datojnë si kohë ndërtimi shek. III p.e.s.133. Duke ju referuar të dhënave të hershme historike, kjo zonë ka qënë e banuar nga fiset ilire të dasaretëve dhe Selca e Poshtme ose Pelioni ka qënë qyteti kryesor i Dasaretisë. Në një prej varreve mendohet të jetë varrosur Kliti, mbreti ilir i Pelionit. Përveç varrezave të cilat janë unikale në Evropë për nga mënyra e ndërtimit në shkëmb, ndodhen edhe disa shkallë, një mur dhe amfiteatri. Për vlerat e larta kulturore që ato përmbajnë janë shpallur monumente kulture në vitin 1971 dhe “Zonë Arkeologjike” në vitin 2010. Varret monumentale të Selcës, të ndodhura në largësi dhe në vështirësi arritjeje nga qyteti i Pogradecit, (46 km) vizitohen spontanisht nga turistët e tërhequr nga monumentet kulturore apo dhe turistët shëtitës në natyrë.

Në rrethin e Kolonjës, ndodhen dy varre monumentale të gdhendur në shkëmb (varri i Sëndyqit-Shtikë dhe varri i Krajlit), që nuk janë monumente kulture, por janë pjesë e vlerave të trashëgimisë prehistorike të saj. Guri i Sëndyqit – Shtikë, ka tipin e një varri “sargofag” dhe ndodhet në një kodër të vogël, 1.5 km para se të shkosh në fshatin Shtikë, komuna Mollas. Varri i Krajlit, është vendosur mbi një masiv gëlqeor që njihet nga banorët si “Çaushko”, 3 km larg qytetit të Leskovikut. Të dy varret ruhen të hapura, pasi u mungojnë kapakët. Ato kanë vlera shkencore, arkitekturore dhe turistike.

- *Banesat*

Banesa është një tjetër element i rëndësishëm dhe spikatës i trashëgimisë arkitekturore të qytetit por edhe fshatit. Zhvillimet social-ekonomike në Shqipëri, pas viteve 1990 e kanë transformuar hapësirën e vendbanimeve rurale dhe urbane duke cënuar karakterin identifikues të tyre. Ndonëse në qytetin e Korçës, banesat e vjetra kanë ardhur duke u pakësuar dhe në mjaft raste zëvendësuar me tipe të reja, qendra historike e qytetit ka ruajtur disa elementë të hershëm të banesës tradicionale. Në mënyrë të veçantë në qytetin e Korçës, mori një zhvillim të dukshëm banesa e hapur me hajat dhe çardak, e cila shoqëroi zhvillimin social-ekonomik të zonës në fundin e shek. XIX dhe fillimin e shek. XX. Disa nga tipet më karakteristike të banesës qytetare në zonën historike të qytetit, paraqesin vlera të veçanta në aspektin arkitekturor dhe turistik. Disa prej këtyre banesave janë godina e Mësonjëtores së Parë Shqipe, banesa e Pandeli Rados, banesa e Zengove, banesa e Vangjush Mios, banesa e Ilo Kotes, etj.

Godina e Mësonjëtores së Parë Shqipe, është një shtëpi dykatëshe, me dritare mbi rrugë dhe oborr të rrethuar me kangjella që ndodhet në bulevardin Shën Gjergji të qytetit të Korçës. Skema planimetrike e saj është konceptuar sipas dobisë funksionale të banesës korçare. Në vitin 1887 kjo banesë u dhurua nga Mandi Tërpo (i zoti i shtëpisë) për mësimin e gjuhës shqipe. Ajo shërbeu si shkollë deri më 7 mars të vitit 1958, kur u shndërrua në muze të arsimit kombëtar. Arkitektura e banesës ku është vendosur muzeu, ekspozimi i dokumentave shkollore të periudhës së çeljes së shkollës së parë shqipe dhe historiku i saj janë elementë tërheqës për vizitorët. Në stendat e Muzeut ekziston fotokopja e Abetares së parë shqipe, e shkruar nga patrioti Kostandin Kristoforidhi. Hyrja është e lirë dhe muzeu shërben gjithashtu për kryrjen e aktiviteteve kulturore si ekspozita piktorësh dhe promovime të tjera në fushën e kulturës.

Banesa e Piktorit të Popullit Vangjush Mio, është shembulli më tipik i banesës së hapur, me vlera të veçanta arkitekturore. Ndërtesa ka pamjen e një banesë dykatëshe, me elemente të tillë si çardaku, hajati dhe qilaret. Karakteristikë është prania e musendrave, ku mbaheshin shtrojet dhe qilimat, si edhe elementet dekorues të drurit në secilën nga dhomat. Në një nga dhomat tyre është shënuar një datë 1841 ndërkohë që një tjetër dhomë, është përdorur si studio nga piktori rreth viteve 30 të shek.XX. Brenda oborrit ngrihet një ndërtesë tjetër që ka shërbyer si "mysafirane". Banesa ka vlera arkitektonike, kulturore, artistike, turistike etj. dhe shërben si muze i piktorit të mirënjohur kombëtar.

Banesa e Ilo Kotes është tepër e veçantë në pamjen e jashtme, të pasur me elementë arkitekturorë. Sipas datës të shënuar në mur mendohet të jetë ndërtuar në vitin 1842. Banesa është dykatëshe dhe në hyrje të saj prezantohet me tre harqe. Trajtimi arkitektonik e dekorativ i tyre është i thjeshtë dhe i pangarkuar me elemente druri. Skema planimetrike i korespondon variantit të banesave me çardak në qendër, të përhapura në qytetet e tjera të vendit, por shënon edhe futjen e tipareve të reja në arkitekturë. Banesa ndodhet në oborrin e muzeut arkeologjik dhe tërheq vëmendjen e vizitorëve vendas dhe të huaj. Megjithëse ka vlera të rëndësishme kulturore, artistike, arkitekturore dhe turistike, ndërtesa vuan mungesën e ndërhyrjeve për mirëmbajtjen e saj. Rijetëzimi i banesës nëpërmjet një rikonstruksioni të përgjithshëm dhe përshtatjes për funksion turistik, do tërhiqte jo vetëm vizitorë por do të ruante edhe vlerat e saj.

Godina e Liceut të vjetër është ndërtuar në fund të shek.XIX dhe fillim të shek.XX. Është një godinë dy katëshe, e pajisur me bodrume. E gjithë godina është e ndërtuar prej guri, me fashaturë dhe dysheme prej druri. Nisur nga vlerat e larta arkitekturore dhe kulturore që ajo përmban është shpallur monument kulture në vitin 1973. Aktualisht kjo godinë kryen funksion arsimor (shkollë e mesme pedagogjike). Zhvillimi social- ekonomik i qytetit të Korçës në fillim të shek. të XX, gjendet i pasqyruar në prezencën dhe huazimin e disa elementëve të veçanta të arkitekturës, të sjella nga vende të tjera. Shembull tipik paraqet banesa rumune, që për sa i përket aspektit arkitekturor ka elementë të ndryshëm nga banesa tradicionale korçare, e mbingarkuar me kolona, harqe, relieve me suva etj. E njëjta pamje vërehet edhe në

ndërtesën e bibliotekës “Thoma Turtulli”, ku ndeshemi me zbukurime të stilit antik, jo fort të zakonata për banesën tipike korçare.

Në qytetin e *Pogradecit* dallohet *lagja Toplec*, si një nga lagjet më të vjetra me kalldrëm.

Kisha e vjetër e qytetit, banesa e Mitrush Kutelit, Lasgush Poradecit dhe familjeve të tjera me tradita kulturore qytetare janë pjesë të trashëgimisë arkitekturore të qytetit.

Krahas banesës qytetare, me tipare të veçanta arkitekturore, të trasmetuara deri në ditët tona, janë dhe banesat e fshatit. Në zonën e Korçës dallohet tipi i banesës dardhare, dy-trekatëshe e ndërtuar me gurë dhe çati me rrasa guri (plloça), i cili është ruajtur edhe në ndërtimet e reja. Po kështu, banesat në fshatin Voskopojë janë të ndërtuara me gurë, sipas traditës së ndërtimit të shtëpive të vjetra voskopojare. Fakti që Voskopoja është shpallur “Qendër Historike”, nga Instituti Monumenteve të Kulturës, ka kushtëzuar respektimin e fizionomisë urbanistike të saj dhe karakteristikave të ndërtimeve të reja. Gjithashtu fshatrat Vithkuq dhe Boboshticë kanë ngjashmëri në arkitekturë dhe tiparet e banesës. Ndërkohë tipi i banesës me gur dhe çati me rrasa guri, është i pranishëm edhe në fshatra të tjerë si Qytezë, Sinicë, në rrethin e Devollit, Niçë, në rrethin e Pogradecit etj.

Tipi kullë i banesës krahas funksionit të banimit ka edhe karakter mbrojtës. Në qarkun e Korçës kulla haset në fshatrat Turan, Malavec dhe Dishnicë. Sipas studiuesve ndërtimi i kullave lidhet me një periudhë historike të veçantë, atë të sistemit të çifligut në Shqipëri (XVII-XVIII).

➤ *Pazari, hanet e qytetit të Korçës*

Në organizimin hapësinor të një qyteti, tregu apo pazari luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin social-ekonomik të tij, nëpërmjet lëvizjes së njerëzve, shkëmbimit të mallrave dhe kulturës. Korça dhe pazari me arkitekturën e tyre shprehin qartë natyrën zejtaro-tregtare të zhvilluar të këtij qyteti. Pazari arriti kulmin e fuqisë së tij gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, që përkon edhe me zhvillimin e vrullshëm të qytetit. Në gjendjen e sotme pazari ruan ato pjesë që u rindërtuan pas zjarrit që e dogji në vitin 1879. Për sa i përket organizimit hapësinor të tij, fizionomia e pazarit dallohet për elementë të pasur arkitekturorë. Po të shikojmë hapësirën e zonimit të pazarit vihet re një ndarje funksionale e njësive prodhuese dhe tregtuese, nga ndërtesat që shërbenin për pushim (hanet). Sipas dëshmimeve dyqanet dhe aktivitetet prodhuese e tregtare kanë qenë të përqendruara sipas zejeve (kovaçinjve, kallajxhinjve, tregtarëve të mishit, tregtarëve e bulmetit, këpucarët, rrobaqepësit, etj). Në pamjen e sotme dyqanet dykatëshe, në arkitekturën e jashtme dhe të brendshme, ruajnë elementët dekorative si qemerët, harqet, kangjellat, qepenat etj.

Pazari i qytetit të Korçës tërheq vëmendjen e vizitorëve për arsye të funksionit të tij, vlerave arkitekturore dhe organizimin hapësinor të tij. Ka vite që i është nënshtruar procesit të rikonstruksionit, për t’u shndërruar në një qendër tregtare tradicionale. Megjithatë i vjetër dhe me vlera të rëndësishme, po aq sa pazaret e vendeve fqinje, Strugës, Shkupit, Prizrenit, Gjakovës, ndonëse ato me kohë funksionojnë si qendra tradicionale tregtare dhe turistike, pazari i qytetit të Korçës ende vuan nga mungesa e vizionit dhe mirëmenaxhimit nga ana e institucioneve përkatëse.

Përveç dyqaneve dhe ndërtesave të tjera, vlera të rëndësishme paraqet edhe prania e

haneve. Ato ndodhen brenda pazarit dhe shërbenin si vende takimi për tregtarët dhe vend çlodhës dhe fjetës për njerëzit që vinin nga larg në pazar, për të tregtuar apo për të blerë. Sipas studiuesve mendohet të kenë qenë 15-16 hane, kurse sot më tipikët dhe më me interes paraqiten hani i Elbasanit, hani i Gjelit dhe hani i Manastirit, të cilët për vlerat e tyre arkitekturore, janë shpallur monumente kulture.

Hani i Elbasanit paraqet interes nga turistët përse i përket kompozimit planimetrik dhe ndërthurjes së elementëve arkitekturorë e dekorative. Në oborrin e brendshëm është i veshur me kalldrëm, ashtu sikurse gjithë rrugët e pazarit dhe rrethohet me ndërtime dykatëshe. Po këtu gjendet një pus. Në katin e dytë dallohen, nëpërmjet një korridorit përshkues, dyert e odave të fjetjes.

Hani i Manastirit ndodhet pranë hanit të Elbasanit me hyrje nga pjesa kryesore e pazarit. Nga ana ndërtimore ai përfaqëson një periudhë më të vonë, e cila ka sjellë të reja kryesisht në teknikë e në material ndërtimi si dhe në mbylljen e njësive të hapura, por ka trashëguar skemat e vjetra kompozicionale. Po ti kthehemi funksionit të haneve, ato kanë shërbyer si bujtëse për të gjithë ata që vinin në qytet dhe zonën e Korçës, për tregëti apo edhe për qëllime të tjera. Tashmë megjithë rikonstrukcionin e pazarit, ato duken larg përshtatjes së tyre për këtë funksion.

- *Urat* janë objekte me vlera arkitekturore që janë trashëguar nga shekujt e kaluar. Disa prej këtyre urave janë shpallur monumente kulture si ura e Golikut në Pogradec, ura e Kovaçit në Voskopojë, ura e Zotos në Vithkuq etj

• **Monumente historike**

Zona e Korçës trashëgon objekte me vlera të rëndësishme kombëtare e më gjerë, dorëshkrime, libra dhe periodikë, që ruhen në muzetë e qytetit të Korçës, Pogradecit dhe Ersekës. Ato mund të konsiderohen si institucionet edukative, që udhëheqin promovimin e trashëgimisë kulturore por njëkohësisht edhe institucionet e konservimit të saj.

➤ *Muzetë*

Trashëgimia historike e qarkut të Korçës ruhet në muzetë e ndërtuar në qytetin e Korçës, Pogradecit, Ersekës, ndër të cilët do të përmendim për vlerat e tyre: Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është hapur në vitin 1980 dhe ndodhet në qendër historike të qytetit të Korçës. Ekspozitat dhe fondet e pasura të tij me objekte historike, kulturore e artistike, që lidhen kryesisht me trashëgiminë e krishtere bizantine dhe pasbizantine, janë shembuj të një pasurie e larmie vlerash të paçmuara. Ekspozimi i tyre është realizuar pjesërisht në sallën e ekspozitës me rreth 200 objekte arti, çka paraqesin vetëm një pjesë të veprave më të mira mesjetare, nga autorë anonime apo të identifikuar. Kështu midis tyre dallohen ikonat e shek. XIII - XIV, duke vijuar më pas me kryemjeshtrat si Oufri, Nikolla, Onufër Qiprioti, Simoni i Ardenicës, Kostandin Jeromanaku, vellezërit Zografi, David Selenicasi etj. Në mes të këtij koleksioni janë rreth 150 autorë ikonografë shqiptare dhe të huaj të zbuluar deri më sot.

Muzeu Kombëtar i Arsimit në Korçë, është ngritur në godinën ku më 7 mars 1887 u hap Shkolla e Parë Shqipe ose “Mësënjtorja”. Arkitektura e banesës ku është vendosur muzeu, ekspozimi i dokumentave shkollorë të periudhës së çeljes së shkollës së parë shqipe dhe historiku i saj janë elementë tërheqës për vizitorët. Në stendat e Muzeut

ekzistonte fotokopja e Abetares së parë shqipe, e shkruar nga patrioti Kostandin Kristoforidhi. Vizitohet nga nxënës, student, vizitorë vendas dhe të huaj. Ndërtesa e muzeut ka tetë mjedise ekspozimi. Në ambientet e muzeut janë të ekspozuara lëndë dokumentare nga historia e shkrimit shqip dhe botime të vjetra në gjuhën shqipe. Në këtë muze pasqyrohet historia e shkrimit shqip, e morisë së alfabeteve deri në alfabetin që kemi sot, vendosur në Kongresin e Manastirit, më 1908, pastaj edhe historia e librit shqip prej abetares së parë të gjuhës shqipe (Evetari, 1744), hartuar nga Naum Panajot Bredhi (Veqilharxhi) e deri te abetaret më të vonshme. Një pjesë e hapësirës së muzeut i kushtohet edhe masivizimit dhe modernizimit të arsimit dhe shkollës shqipe në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore.



Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar është nga objektet më të vizitueshëm në qytetin e Korçës, veçanërisht nga turistët ndërkombëtarë. Ekspozita e muzeut është vizituar nga ekspertë të fushës së artit mesjetar dhe restaurimit, nga një numër i konsiderueshëm artdashësish, pelegrinësh, studentësh, nxënësish vendas dhe të huaj. Në vitin 2009 muzeu u vizitua nga 3180 vizitorë vendas dhe të huaj, ndërkohë që në vitin 2012 numri i vizitorë ishte 4652, prej të cilëve 1534 vizitorë vendas dhe 3118 vizitorë të huaj. 150 Prezantimi i vlerave për vizitorët e huaj bëhet nga dy specialistë të muzeut, kryesisht në anglisht dhe italisht, por nuk mungon edhe në gjuhë të tjera.



Muzeu Arkeologjik, u krijua në vitin 1985, por formë të plotë mori pas vitit 1990. I vendosur në një ndërtesë karakteristike korçare, të fillimit të shek XIX, muzeu Arkeologjik i përket prehistorisë së zonës juglindore dhe është i veçantë në llojin e vet. Këtu janë të ekspozuar 1200 objekte autentike të zbuluara nga gërmimet arkeologjike në shumë vendbanime prehistorike, që tregojnë zhvillimin e kulturës në Shqipërinë Juglindore, që nga mijëvjeçari i gjashtë para Krishtit deri në shek.VI. Me mjaft interes paraqiten maketet e disa vendbanimeve të rëndësishme prehistorike si: Maliqi, Dunaveci, Trajani, etj. Ky muze vizitohet nga nxënës, vizitorë vendas dhe të huaj. Në vitin 2012 muzeu u vizitua nga 3760 vizitorë vendas dhe të huaj. Hyrja në muze është kundrejt biletës prej 200 lekë. Megjithë interesin e konstatuar të vizitorëve të huaj, gjendja dhe mirëmbajtja e tij, lë për të dëshiruar dhe nuk i përgjigjet vlerave arkeologjike dhe arkitekture që ky muze posedon.



Muzeu Historik i rrethit të Kolonjës, në qendër të qytetit e Ersekës, është një ndër muzetë e parë të hapur në shkallë republike (shkurt 1962), që e ruan fizionominë e tij edhe në ditët e sotme duke i shpëtuar shkatërtimeve të viteve të tranzicionit. Triptiku në fasadën e tij, vepër e skulptorit Vasiliev Nini, pasqyron etapat e zhvillimit historik të trevës së Kolonjës, që në prehistori dhe deri në fund të periudhës së diktaturës. Në katin e parë, është pozicionuar në një mjedis të veçantë “oda e miqve” ose “oda kolonjare”, ku shpalosen traditat e kësaj treve. Kjo pëlqehet shumë nga turistët vendas dhe të huaj që e vizitojnë atë. Muzeu mbart vlera të rëndësishme arkeologjike, kulturore, artistike dhe turistike, por vizitohet shumë pak. Në vitin 2012 ai u vizitua nga 110 vizitorë, kryesisht ndërkombëtarë, të cilët janë pjesë e itinerarit KorçëErsekë-Leskovik-Përmet-Gjirokastrë.



Shtëpia muze e piktorit Vangush Mio, përbën një tjetër atraksion turistik (monument kulture) me një fond pikturash të ekspozuara me larmi peisazhes, natyrë të qetë si dhe shumë vizatime, të cilat janë të njohura për stilin e veçantë të realizimit. Vangush Mio është piktori i parë shqiptar i peisazhit që ka hapur ekspozitën e parë në Tiranë në 1920. Vizitohet nga të apasionuarit e peisazhit dhe pikturës.



➤ **Dorëshkrimet**

Krahas monumenteve arkeologjike dhe arkitekture, ekzistenca e burimeve dokumentare të shkruara, janë një element i rëndësishëm i trashëgimisë sonë, që dëshmojnë për zhvillimin shoqëror, historik dhe kulturor të trevave të veçanta dhe gjithë Shqipërisë. Një vend të veçantë dhe një pasuri të çmuar përbëjnë dorëshkrimet

bizantine dhe postbizantine të njohur si Kodikët e Shqipërisë. Janë një fond prej 100 kodikësh, të cilët ruhen në Arkivin Qendror Shtetëror, si një pasaportë kulturore e padiskutueshme e identitetit dhe krenarisë sonë kombëtare. Në këtë pasuri një vend të rëndësishëm krahas Kodikëve të Beratit, zenë edhe kodikët e Korçës.

Kodiku i Metropolisë së Korçës dhe Sefalosforit i vitit 1676, i hulumtuar nga mjaft studiues brenda dhe jashtë vendit, ka hedhur dritë mbi veprimtarinë ekonomike, shoqërore dhe kulturore të trevës së Korçës në shekujt XVIII-XIX¹⁵¹. Po kështu më vlera paraqiten gjithashtu kodiku i Voskopojës si dhe kodiku i Korçës (Katërrungjillëshi i shek.X), i cili dëshmon për lidhjen në përgjithësi të mjedisit të Shqipërisë së sotme me kryeqendrën kulturore të Bizantit. Promovimi së fundmi në qytetin e Korçës, i botimit të parë faksimile i Kodikut të Korçës, bëri të njohur vlerat shkencore, artistike, historike dhe fetare të kësaj trashëgimie.

• **Monumente të kultit**

Në qarkun e Korçës rrethanat historike kanë bërë të mundur të kultivohen dhe bashkëjetojnë tre komunitete fetare kryesore: *të krishterë, myslymane dhe bektashinj*. Gjurmët kulturore të këtyre besimeve janë pasqyruar në ndërtesat e kultit si edhe në objektet e ndryshme fetare të cilat, përveç se janë dëshmi e kultivimit të besimit fetar përfaqësojnë edhe vlera të jashtëzakonshme artistike dhe kulturore për qarkun dhe për gjithë trashëgiminë kulturore. Nisur nga vlerat që ato përmbajnë një pjesë e tyre janë shpallur monumente kulture të kategorisë së parë (njëzet e shtatë kisha, një xhami, 3 teqe dhe një tyrbe).

➤ *Objektet e kultit kristian (kishat)*

Materiale dokumentare të kodikëve si edhe burimeve të tjera të shkruara, shprehin zhvillimin e jetës kulturore të Korçës dhe trevave të saj edhe nëpërmjet ngritjes së një morie veprash kulti me vlera arkitekturore dhe artistike. Përveç rëndësisë që paraqesin në aspektin religjioz (fetar), objektet e kultit janë në qendër të interesit të vizitorëve vendas dhe të huaj. Disa nga objektet e kultit kristian të shpallura monumente kulture janë:

Kisha trekonshe e Linit (Bazilika) Pogradec, është një nga ndërtimet e kultit që ruhen në Shqipëri, e rëndësishme për nga vlerat që mbart. I gjithë kompleksi i ka dyshemetë të shtruar me mozaikë, gjurmët e të cilëve flasin qartë për vlerat artistike të monumentit. Në mozaikët e kësaj bazilike motivi më i përdorur është ai i pjergullës, krahas luleve, shpendëve si edhe disa motiveve më pak të përdorura në mozaikët e tjerë të Shqipërisë si, lepujt dhe bletët. Ngjyrat mbizotëruese të tyre janë: e bardha, e zeza dhe e kuqja, por janë përdorur edhe ngjyra të tjera si kafja, jeshilja, e verdha dhe portokallia. Duke patur parasysh afërsinë planimetrike, vendodhjen e tyre, ngjashmërinë stilistike të mozaikëve dhe të përmbajtjes së skenave të tyre, mendohet se kisha trikonshe e Linit duhet të jetë ndërtuar në fillim të shek. VI¹⁵⁵ dhe është restauruar në vitet 2008-2009. Ajo përbën një objekt të vizitueshëm nga turistët e huaj.

Kisha e Shën Jovanit (Boboshticë) Korçë, dallohet për pamjen e jashtme të ndërtimit të saj dhe vlerat artistike të veçanta në mjediset e brendshme, ku të bien në sy muret e veshura me piktura murale. Nisur nga teknika dhe materialet e ndërtimit, studiuesit mendojnë se kisha daton në gjysmën e dytë të shek. XIV.

Kisha e Shën Mitrit në Bezmisht, ndodhet veri të fshatit me të njëjtin emër, buzë liqenit të Prespës, në të cilin ndodhen gjithashtu shpella eremite, që ruajnë piktura të periudhës së parapshtimit turk. Mbi bazën e teknikës së ndërtimit kualsonazh, sipas studiuesve mendohet se kisha është ndërtuar gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV.

Kisha e Shën Mërisë në ishullin e Maligradit, ndodhet në ishullin e vogël me të njëjtin emër, në Liqenin e Prespës së Madhe. Është ndërtuar në një shpellë të shkëmbore e hapur nga liqeni. Në kishë hyhet nëpërmjet një porte dykanatëshe druri të gdhendur. Sipas mbishkrimeve kisha i është nënshtruar ndryshimeve. Mendohet që fillimisht data e ndërtimit të kishës të jetë viti 1345/158, ndërkohë që në vitin 1369 kishën e rindërton Kesar Novaku 159. Pikturat murale kanë vlera artistike, fetare dhe turistike. *Kisha e Ristozit në Mborje*, është ndërtuar në fshatin Mborje në juglindje të qytetit të Korçës. Në arkitekturën e saj kisha paraqitet mjaft kompakte, ndërsa muratura e kishës është e përbërë nga gurë të papunuar, me copëra tjegullash të vendosura njëra mbi tjetrën ndërmjet gurëve, po jo gjithandej. Sipas burimeve të shkruara mendohet që kisha të jetë ndërtuar gjatë shekullit të XIV. Vizitohet nga mijëra vizitorë në rastet e festave fetare, por edhe nga turistë të huaj. Ndonëse monument me vlera të rëndësishme kulturore, aktualisht vuan mungesën e ndërhyrjeve për restaurimin e saj.

Kisha e Shën Triadhës në Lavdar të Oparit, ndodhet në fshatin Lavdar të komunës Lekas në rrethin e Korçës. Kisha është ndërtuar në shek. XV nga Ana, e bija e sundimtarit të Gjirokastrës, Gjin Zenevisit, e ëma e Gjin Muzakës dhe gruaja e II Muzakës Andre. Dallohet për një arkitekturë të veçantë, por ishte krejtësisht e dëmtuar nga ndryshimet në kohë. Në vitin 2013 kisha u restaurua nga Drejtoria e Kulturës Kombëtare Korçë, duke nxjerr në pah një monument kulture me vlera të jashtëzakonshme.

Kishat e Voskopojës

Voskopoja që përmendet në kohën e lulëzimit të saj për shkolla dhe institucione kulturore, (shek. XVIII) përmendet midis të tjerave për numrin e bazilikave, me elementë arkitekturorë dhe artistikë me vlera unike, që përbëjnë sot dëshminë e qytetërimit mesjetar. Manastiri Shën Prodhomit, Bazilika e Shën Kollit, Bazilika e Shën Thanasit, Bazilika e Shën Mërisë, Bazilika e Shën Mëhillit dhe Shën Dëllisë. Manastiri i Shën Prodhomit është ndërtuar në shekullin e XVII, në vitin 1632, kur fshati i Voskopojës po merrte fizionominë e një qendre të rëndësishme zejtarotregtare. Këtu ndodhet edhe kisha trekonëshe, e dallueshme nga stili bizantin në formë kryqi. Muret janë të veshura me piktura murale dhe ndonëse aktualisht rezultojnë të dëmtuara dallojnë qartë elementët e gdhendur me vlera të veçanta artistike.

Bazilika e Shën Kollit është një nga pesë bazilikat më madhështore të ndërtuara në Voskopojë dhe që ruhet fare mirë edhe në ditët tona. Nga mbishkrimi që ndodhet në pjesën perëndimore të saj, studiuesit dëshmojnë se kishën e ka pikturuar D. Selenicasi me dy ndihmësit e tij. Kisha është ndërtuar në vitin 1721 dhe është pikturuar në vitin 1726.

Pikturat murale mbartin vlera të pakrahasueshme artistike, fetare dhe turistike.



Bazilika e Shën Thanasit i përket periudhës pasbizantine dhe sipas mbishkrimeve rezulton, që kisha të jetë ndërtuar në vitin 1726. Pikturat murale në këtë kishë ndonëse të dëmtuara, ruhen më mirë se në kishat e tjera. Kisha e Shën Gjergjit në

Shipskë, gjendet në hyrje të fshatit, rreth 5 km larg Voskopojës. Nga arkitektura dhe teknika e ndërtimit, mendohet të jetë ndërtuar në mesin e shek. XVII, çka e bën atë një nga shembujt më të hershëm të këtij tipi bazilikal, gjatë periudhës postbizantike. Restaurimi tërësor dhe pastrimi i pikturave ka nxjerr në pah vlerat kulturore, fetare, artistike dhe turistike të kishës.

Prej disa vitesh kishat e Voskopojës me vlerat e tyre kanë zgjuar interesin e turistëve të huaj dhe vizitorëve vendas. Vizitat në këto objekte kulti bëhet me bileta kundrejt një pagese modeste. Në kishën e Shën Kollit në qendër të fshatit, kryhen ritet dhe ceremonitë fetare të komunitetit të zonës dhe prifti kryen gjithashtu rolin e shpjeguesit të vlerave të kishës për vizitorët. Kishat janë monumente kulturore dhe mbrohen me legjislacion të veçantë, ashtu sikurse menaxhohen nga institucionet përkatëse, puna e të cilave në këtë drejtim nuk paraqitet në nivelin e duhur.

Vithkuqi radhitet krahas Voskopojës për praninë e kishave dhe madhësinë e vlerave të tyre.

Kisha e Shën Mëhillit Vithkuq, gjendet në veriperëndim të Vithkuqit, në anën e djathtë të rrugës që të çon në fshatin Shtyllë, pranë varrezave të vjetra, jo shumë larg nga qendra. Nga mbishkrimet që gjenden në të, mendohet të jetë ndërtuar në fund të shek.XVII dhe fillim i shek.XVIII. Brenda saj muret janë të veshura me piktura murale me vlera të çmuara artistike. Manastiri i Shën Pjetrit dhe kisha e Shën Kozmait (qimitiri) gjendet në një një kodër të pjerrët, pa arritur në fshatin Vithkuq. Është ndërtuar në vitin 1709 dhe është pikturuar nga brenda në 18 Maj 1750.



Arkitektura dhe urbanistika e ndërtimit është e veçantë. Edhe këtu të bien në sy pikturat e vëllezërve Zografi, të cilët pikturuan kishën e manastirit. Është një asambël kishtar me kupolë ndriçimi me fanare dhe oborr të brendshëm. Në krah të Shën Pjetrit është edhe *kisha e Shën Kozmait dhe Damianit*, e cila është e një natyre të veçantë. Emërtohet ndryshe dhe qimitir, pasi në të ruhen eshtrat e të vdekurve. Ka vlera shkencore, kulturore, fetare, turistike etj. Kisha e Shën Mërisë dhe kisha e Shën Gjergjit (monumente kulture) ndodhen gjithashtu në fshatin Vithkuq dhe mbartin vlera të rëndësishme arkitekturore, artistike, fetare dhe turistike.

Kisha e Shën Marenës, ndodhet në veri të fshatit Llëngë, në rrethin e Pogradecit. Ndonëse është ndërtuar e re, vendodhja e saj në një zonë me bukuri dhe monumente natyrore i jep krahas të tjerave vlera kulturore dhe turistike.

Katedralja Ringjallja e Krishtit është ndërtuar në vitin 1994 dhe shërben për kryerjen

e të gjitha riteve fetare të besimtarëve të krishterë ortodoks. Ndonëse e re dhe nuk gëzon statusin e monumentit të kulturës, ajo përbën një nga simbolet kulturore të qytetit të Korçës me vlera artistike në arkitekturën e jashtme dhe zbukurimet e brendshme murale të saj. Në vazhdim të traditës së pikturimit të kishave, është për t'u evidentuar fakti se besimtarët ortodoksë janë duke kontribuar në veshjen e brendshme me piktura murale. E ndodhur në qendër të qytetit katedralja është objekti kulturor që vizitohet dhe vlerësohet nga të gjithë turistët e huaj dhe vizitorët që vijnë në qytetin e Korçës.

➤ *Objektet e kultit mysliman*

Objektet e kultit mysliman përfaqësohen nga xhami apo teqe, të cilat për vlerat arkitektonike dhe artistike që mbartin, janë të shpallura monumente kulture. Disa nga këto objekte mund të rendisim:

Xhamia e Iliaz Bej Mirahorit në qytetin e Korçës është më e vjetra e këtij tipi në vendin tonë (xhami me sallë të mbuluar me kupolë). Sipas mbishkrimit të vonë (1872-1873) mbi portën e hyrjes, xhamia është ndërtuar në vitin 1495-6, (901 H) nga Iliaz Beu, me origjinë nga Panariti, Mirahor, komandant i stallave të Sulltan Bajazitit të II 169. Xhamia përbëhet nga salla e lutjeve, portiku tri pjesësh dhe minarja 170 dhe mendohet të jetë ndërtuar mbi rrënojat e kishës së Shën e Premtes në fshatin Peshkëpi, fare pranë qytetit të Korçës. Për nga arkitektura është vlerësuar si ndërtim nga më të arriturit, që ndonëse e vogël është një ndërtesë monumentale. Studiuesit e krahasojnë atë me mjaft xhami bashkëkohore të Stambollit. Por teknika e ndërtimit të mureve, ndryshon tërësisht nga ndërtimet turke, gjë që flet për një traditë ndërtimore vendase. Gjendja e mirë arkitekturore pas restaurimit e ka kthyer në një objekt atraktiv për vizitorët e huaj.

Teqeja e Qesarakës-Kolonjë, ndodhet rreth 50 km larg nga qyteti i Korçës dhe rreth 30 km nga qyteti i Ersekës në fshatin me të njëjtin emër. Kjo teqe mendohet se është ndërtuar në vitin 1600 dhe themelues i saj ka qenë Haxhi Babai nga Irani. Teqeja e Qesarakës është një kompleks i përbërë nga dy ndërtime: varri monumental (mauzoleu) që quhet tyrbe dhe konaku, që është banesa apo rezidenca ku jeton Babai. Ndërhyrjet restauruese kthyen tipologjinë dhe arkitekturën e kohës, duke e bërë më interesante dhe më tërheqëse për besimtarët dhe vizitorët. Me restaurimin e teqesë, *Urdhëri i Dervishëve Bektashi* në Shqipëri, ka një monument historik të konservuar me të gjitha vlerat e tij shkencore, arkitektonike, fetare dhe turistike.

Teqeja e Turanit e ngritur në vitin 1827 përbën gjithashtu, një monument kulture të rëndësishëm për besimtarët myslimanë por edhe për vizitorë të ndryshëm.

• **Monumentet artistike**

Gjurmët e artit figurativ në Shqipëri janë të hershme, që në periudhën e neolitit me zbulimin e qeramikave, terrakotave, zbukurimeve me metal etj. Lulëzimi i qyteteve ilire sollti edhe zhvillimin e artit ilir me pikturimin e qeramikës, skulpturën, mozaikët dhe afreskët. Në qarkun e Korçës trashëgohen një mori veprash arti si mozaikë, afreske, ikona, piktura, skulptura, fotografi artistike etj, vlerat e të cilave nuk mund të kuptohen jashtë ambjenteve të cilave u përkasin. Këto në pjesën më të madhe të tyre ruhen në muzetë e qytetit të Korçës, Ersekës dhe Pogradecit.

➤ *Piktura murale*

Në periudhën e mesjetës arti i pikturës gjeti shprehjen më të lartë artistike. Piktorë të shquar të shekullit të XVIII si David Selenicasi, Kostandin Shpataraku, Vëllezërit Kostandin dhe Athanas Zografi, familja Katro, pikturuan kishat në Shqipëri dhe vendet fqinje. Përveç vlerave arkitekturore dhe fetare kishat e Voskopojës, Vithkuqit, Boboshticës, Prespës dhe gjithë kishat e tjera në qarkun e Korçës, dallohen edhe për vlerat artistike të pikturave murale, ikonostaseve dhe ikonave. Pikturat paraqesin tema të shumta të trajtuara me kontekst fetar. Veprat më të çmuara të këtij fondi pikturash të artit bizantin dhe pasbizantin ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar në qytetin e Korçës. Disa prej këtyre pikturave murale do të përmendim: “Ava Shëruesi”, “Lindja e Krishtit”, “Shërimi i barinjve të vjetër” piktura të shek.XVIII, nga David Selenicasi në kishën e Shën Kollit. Në manastirin e Shën Prodhomit në narteksin e kishës gjejmë piktura murale shënjtoreësh të piktorit vendas Andon Shipska (Jeromonaku) ashtu sikurse afreske shënjtoreësh në kishën e Shën Mëhillit. Në kishën e Shën Gjergjit në Shipskë, gjatë restaurimit u zbulua vazhdimi i pikturës murale “Gjyqi i fundit”. Tradita e pikturës murale vazhdon ende edhe në kishat e ndërtuara kohët e fundit. Kështu katedralja “Ringjallja e Krishtit”, kisha e Shën Thanasit dhe kishat e tjera në qytetin e Korçës vazhdojnë të zbulohen me piktura murale.

Përveç pikturave murale vlera artistike përbëjnë edhe *ikonat* dhe ikonostaset të cilat i gjejmë të pranishme në pothuajse të gjitha kishat (Voskopojës, Maligradit, Vithkuqit, Boboshticës, Mborjes etj). Ikonat më të çmura ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar (veprat e ikonografit të shquar Jeromonak Kostandini). Veshja e tipareve të shënjtoreëve në skenat e spiritualizmit fetar, me pamje që i afrohej jetës reale, është një element i pasqyrimin të zhvillimit social-ekonomik të kohës në art. Një pasqyrim të tillë e gjejmë tek skena e “mbjellësit të farës” e piktorit David Selenicasi.

- Krahas monumenteve më karakter religjioz, *skulptura* është një gjini artistike që ka gjetur mishërimin e vet edhe në qarkun e Korçës me vepra të realizuara nga mjeshtrat e skulpturës kombëtare. Në gjithë fondin e kësaj gjinie, vetëm dy prej tyre që ndodhen në qytetin e Korçës kanë statusin e “Monumentit të Kulturës”: Monumenti i Luftëtarit Kombëtar ose siç njihet ndryshe ”Ushtari i panjohur”, që ndodhet në zonën këmbësore të qytetit, i ndërtuar me mjeshteri nga Odhise Paskali në vitin 1932.

Monumenti mishëron vlerat atdhetare të një krijimi realist por edhe vlera artistike dhe turistike. Monumenti i Themistokli Gërmenjit gjithashtu monument kulture, ndodhet brenda lulishtes me të njëjtin emër dhe është ndërtuar në 1932, përsëri nga mjeshtri Odise Paskali.

Me vlera kulturore paraqiten edhe disa monumente të tjera si: Monumenti “Koci Bako” ndërtuar nga Dhimitër Çani (1950); monumenti ”Naim Frashëri”, në rrugën “28 Nëntori” ndërtuar nga Avni Bilibili më 1956; monumenti ”Partizani” pranë varrezave të dëshmorëve ndërtuar (1969) nga Avni Bilbili, Piro Dollaku e Ilia Xhano; monumenti “Mihal Grameno” (1969) nga Montas Dhrami; monumenti “Naum Veqilarxhi” (1974); Obelisku ABC në oborrin e muzeut “Mësonjëtorja e Parë Shqipe” ndërtuar nga Naumaq Mara (1987); busti “Tre kokat” (Naum Veqilarxhi, Thimi Mitko dhe Asdreni) ndërtuar nga Vladimir Topi, Avni Bilbili dhe Vladimir Kaçaku¹⁷⁷ (2002); monumenti “Mitrush Kuteli” dhe “Lasgush Poradeci” në qytetin e

Pogradecit.

➤ *Fotografia*

Krahas gjinive të përmendura më sipër, *fotografia* është një gjini tjetër artistike që përmendet në trevën e Korçës, në gjysmën e dytë të shekullit të XIX178. Në fillim të shekullit të XX (1923) në Korçë u çel studioja e fotografit Kristaq Sotiri, ndërkohë që në qytet kishte edhe studio të tjera fotografësh të njohur. Tradita e fotografisë dëshmohet në organizimin e herëpashershëm të ekzpozitave të fotografive dhe ekzistencën e disa studiove fotografike në qytetin e Korçës dhe të Pogradecit.

• **Trashëgimia etnografike**

Me veshjet popullore, prodhimet e artizanatit në dru, gur, tekstile, qëndisje dhe thurje si dhe punimet prej metali, trashëgimia etnografike përbën një pjesë të trashëgimisë kulturore shqiptare, me vlera të pazëvendësueshme. Është për t'u vlerësuar ekzistenca e disa krahinave me etnografi të pasur si: Korça, Opari, Prespa, Devolli, Kolonja, brenda hapësirës sonë të studimit, çka e bëjnë të larmishme jo vetëm në aspektin studimor por edhe turistik.

➤ *Veshjet popullore*

Veshjet popullore në përgjithësi dhe kostumet popullore në veçanti, vlerësohen të jenë një thesar i traditave të kulturës popullore shqiptare. Uniteti ekonomik dhe shoqëror i një zone, ka sjellë afrime edhe në veshjen e krahinave, që bëjnë pjesë në këtë unitet. Ato konsiderohen si objekte etnografike të përdorimit të përditshëm ose në raste festash, të përbëra prej materialeve të tilla si liri, leshi, lëkura, pambuku, mëndafshi, etj. Nëpërmjet studimit të veshjeve popullore shqiptare, ne njihemi jo vetëm me një aspekt shumë të rëndësishëm të mënyrës së jetesës, por edhe me aspekte të tjera si zhvillimi ekonomik, shoqëror, kulturor e artistik i fshatrave e qyteteve në zonat e ndryshme, ku këto veshje janë mbajtur. Trashëgimia dhe ruajtja e kostumeve popullore të zonave të veçanta të trevave të Korçës, fshatit dhe qytetit, është një element mjaft i rëndësishëm për t'u vlerësuar. Referuar morisë së studimeve arkeologjike, historike dhe kulturore studiuesja dhe etnografia Andromaqi Gjergji ka bërë klasifikimin e veshjeve popullore shqiptare të burrave dhe grave, nga ku do të prezantojmë tipet kryesore të tyre në zonën e Korçës.

Veshja e burrave me fustanellë, ku fustani është elementi më karakteristik i këtij tipi veshjeje, i përmendur në disa dokumente të shekullit të XIV. Fustanella është e bardhë, me material prej pëlhure të pambuktë, që punohej në shtëpi ose ishte e fabrikuar. Shoqërimi me elementë të tjerë si: këmisha, jeleku, brezi, kalcet e shajakut dhe opingat prej lëkure, plotësonin më së miri prezencën e saj në disa zona të qarkut, në veçanti në zonën malore të Korçës (Dardhë), Kolonjës dhe Devollit. Në shkrime të ndryshme dëshmohet të ketë qenë e pranishme deri në vitet 1920, kryesisht në raste festash. Prania e kësaj veshje tipike shqiptare tek grekët apo popuj të tjerë ballkanas, dëshmon për rolin aktivdhënës të kulturës sonë materiale, në elementin kulturor të veshjes së fqinjëve tanë. Kostumi me këmishë të gjatë e dollama (cibun) krahas këmishës së gjatë, që ishte elementi kryesor, cibuni, mëngorja dhe kalcet ishin mjaft të pranishme dhe të përdorshme. Kjo veshje e burrave ishte karakteristike për zonën e

Korçës, të Kolonjës dhe fshatrat e Prespës dhe ndryshe nga veshja e përditshme në ditët e festave karakterizohej nga prania e qendismave dhe stolive.



Veshja me poture ndonëse në përhapje të kufizuar, u përdor pas veshjes me fustanellë në malësitë e Korçës dhe Kolonjës. Festja e bardhë, e zezë ose e kuqe ishte një element i rëndësishëm që shoqëronte veshjen e burrave të fshatit dhe të qytetit.

Veshja e grave me këmishë të gjatë dhe një përparje, është një tip mjaft i përhapur veshjeje në disa zona të qarkut të Korçës, Dardhës, Gorës, Oparit në Korçë dhe Kolonjës. Një vend më vete në këtë tip veshje zë veshja e grave ish ortodokse të Mokrës (Pogradec). E gjendur në disa variante, në pamjen e jashme këmisha e gjatë shtrëngohej pas belit me një brez të zbukuruar. Përsipër veshja shoqërohej me një lloj dollmaje e zbukuruar në fund me qëndisje. Kjo veshje shfaqet me elemente më të zhvilluar në veshjen e gruas dardhare në rrethin e Korçës.

Karakteristikë për trevat e Korçës janë edhe *veshjet e modës qytetare për burra dhe*

gra, të pranishme atje ku kushtet e zhvillimit ekonomik ishin pjekur për një asimilim të tillë. Përmendet veshja me dollma të gjatë e xhybe me gëzof, që mbanin burrat ortodokse të qytetit të Korçës, të Voskopojës që nga shekulli i XVIII deri në shpalljen e Pavarësisë. Veshja me origjinë qytetare ishte ajo që mbanin gratë ortodokse të qytetit të Korçës në çerekun e fundit të shek. XIX, e përfaqësuar nga fustane të gjera të shoqëruara me një xhybe cohe të zezë, me gëzof te qafa e me shami të zezë në kokë. Veshjet ndryshonin nga fshati në qytet.

Burrat e fshatit në zonat malore e plotësonin veshjen e tyre me guna me kapuç kryesisht në stinën e dimrit.

Veshjet popullore të burrave dhe grave dallohen për kryerjen e funksioneve të ndryshme siç janë: veshjet e përditshme ose për punë, kryesisht praktike dhe të punuara me materiale të lira; veshje sipas moshës, seksit e gjendjes civile; veshje të mira ose për të dalë. Veshjet e grave ishin të zbukurura me qëndisma dhe stoli metalesh të çmuara dhe shoqëroheshin me byzylykë, breza metalikë, kollanë, unaza etj. kryesisht të përdorshme në raste të veçanta dhe festash. Krahas elementeve të përmendur më sipër, një element po aq i rëndësishëm që shoqërojnë këto veshje janë opingat e lëkurës me ose pa xhufka, të cilat paraqiten në variante të ndryshme si tek burrat dhe tek gratë.

Të gjithë elementët e përmendur më sipër ruhen në mënyrë individuale në shtëpi apo janë pjesë dekorative e restoranteve apo bareve kryesisht të fshatit por edhe qytetit. Është për t'u evidentuar mungesa e muzeve etnografik në zonat përkatëse, që dikur kanë ekzistuar. Nisur nga vlerat e rëndësishme që mbart kjo pjesë ë trashëgimisë, mendojmë se ngritja e një muzeu etnografik rajonal me veshjet popullore dhe objekte të mbledhura nga të gjitha krahinat e Korçës, do të zgjeronte ofertën turistike të trashëgimisë kulturore dhe njëkohësisht do t'a ruante këtë nga dëmtimet e kohës.

• **Artizanati dhe punimet tekstile**

Populli shqiptar krahas veshjeve popullore ka trashëguar edhe një art popullor të zhvilluar dhe të larmishëm me elementë të arrirë në disa fusha si, qeramika, punimi i gurit dhe drurit, tekstilet dhe qëndisjet popullor, si dhe punimin e metalit dhe të argjendit. Në zonat e Korçës, kjo krijimtari është trasmetuar brez pas brezi dhe ruhet ende në ditët tona, si pjesë e pandarë e gjithë trashëgimisë kulturore materiale. Artizanati në këtë zonë ka origjinë të hershme, që me prodhimin e sendeve të domosdoshme për jetesë, gjë të cilën e njohim nëpërmjet gjetjeve të shumta të objekteve arkeologjike (vegla pune, enë prej balte, stoli dhe byzylykë). Këto spikatin për shumëllojshmëri elementesh, forma dhe paraqitje estetike, që gjenden të ekspozuara në muzeun Arkeologjik dhe muzeun e rrethit të Kolonjës. Duke vazhduar në mënyrë të pandërprerë gjatë gjithë kohërave, artizanati përbën një nga pikat e forta të ruajtjes së identitetit dhe mundësi reale të integritit të kësaj tradite në zhvillimin e turizmit. *Qeramika dhe punimet e baltës* kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mënyrën e jetës së banorëve të lashtë. Përveç funksionit dhe teknikës së tyre të prodhimit, ato mbartin edhe elemente artistikë zbukurues, si shprehje të nivelit kulturor. Enët e ujit, bardhakët, shtamat me forma të larmishme dhe me ndonjë zbukurim, që prodhoheshin në Bradvicë të Korçës, furnizonin pellgun e Devollit, fshatra të ish Rep. Maqedonisë dhe Greqisë Veriore¹⁹⁰. Tradita vazhdon nëpërmjet ekzistencës së punishteve të qeramikës në qytetin e Korçës dhe në zona të tjera të

qarkut.

➤ *Punimet e drurit* kanë zënë një vend të rëndësishëm në shek.XVIII-XIX, ku u përdorën gjerësisht në ndërtimet e jashtme dhe të brendshme të banesave qytetare dhe fshatare. Motivet e përdorura në gjininë e artit të thandrimin në dru dhe ekzekutimi i tyre, për dekoracione të ndryshme të brendshme në objektet e kultit dhe banesat dëshmojnë qartë, për nivelin artistik të këtyre punimeve të artit popullor. Dritaret, kanapet, dollapët në mur, shkallët e brendshme, tavanë të skalitur me shije dhe orendi të tjera prej druri janë ende dëshmi e tipit të banesës së vjetër. Perfeksionimi i punimeve të drurit e gjen shprehjen e tij në objektet dhe punimet e brendshme të kishave ortodokse si ikonostaset dhe ikonat. Krahas atyre që gjenden në Muzeun e Artit Mesjetar, kishat e Voskopojës, por edhe kishat e tjera janë të pasura me këto objekte me vlera artistike.



➤ *Gdhendja dhe punimi i gurit* është një traditë e hershme shekullore. Qyteti i Korçës

dhe shumë fshatra kanë trashëguar rrugicat e shtruara me kalldrëm dhe shtëpitë e ndërtura me gur. Mund të përmendim gjithashtu gdhendjen e kolonave në banesat e qytetit, sofateve e çezmave nga mjeshtrit polenakë në fshatin Polenë, Progër të rrethit të Devollit, mjeshtrit kolonjarë të përpunimit të gurit të njohur edhe jashtë vendit etj. Po kështu vazhdon tradita e ndërtimit të oxhakëve, në pjesën më të madhe për përdorim funksional por edhe për dekorim të ambjenteve të brendshme.

➤ *Punimi i metalit të hekurit* është gjithashtu një traditë shekullore. Rrethimi I banesave me kangjella prej metali të zbukuruara me elemente, është element i rëndësishëm tradicional dhe qytetarie.

Mjeshtërat e punimit të hekurit realizojnë punime të atij niveli që po gjejnë përdorim jo vetëm në mjediset rrethuese por edhe brenda ambjenteve të banesave apo lokaleve. Në përpunimin e metalit një vend të rëndësishëm ka zënë edhe punimi i argjendit. Argjendarët e Voskopojës dalloheshin për punimet cilësore. Po kështu zbukurimet e argjendit si pafta, breza, gjerdanë dhe stoli të tjera zbukuronin veshjen e gruas në krahina të ndryshme të qarkut të Korçës.

Fondi i artit tonë mesjetar tërheq vëmendjen edhe për punimin e kapakëve që

shërbenin për mbështjelljen e librave, disa të tillë i disponon muzeu i Artit Mesjetar. Karakteristikë për trevën e Korçës është dhe *punimi i mermerit*, me të cilin zbukurohen fasadat e ndërtimeve të veçanta me elemente të arkitekturës moderne.

Punimi i lëkurës ka qenë dhe është traditë për qytetin e Korçës dhe rrethinat. Ka një fabrikë të prodhimit të këpucëve që punon për tregun vendas. Ekzistojnë edhe një sërë punimesh tekstile artizanate dhe specialitetesh lokale karakteristike, si për shembull qilimat e punuara me dorë, batanijet karakteristike, punimet me thurrje (punimet me shtiza), qëndistaria në zonat e Pogradecit, Kolonjës etj. Niveli artistik i qilimave të punuara në qarkun e Korçës (sidomos i qytetit të Korçës) është nga më të arrirët. Skemat e përdorura në tekstilet e kësaj zone kanë një kulturë e sens artistik më të zhvilluar përse i përket kompozimit të ngjyrave, gjë që i dallon menjëherë tekstilet e Korçës nga ato të zonave të tjera. Dallohen sidomos qilimat dhe velenxat, me motive dhe ngjyra të larmishme. Përdorimi i ngjyrave veç funksionit estetik, shprehte edhe momentet e jetës, gëzimet dhe hidhërimet, gjendjen shoqërore etj. Kjo gjë duket qartë edhe në veshjet, sidomos ato të grave dhe vajzave. Pothuajse në çdo shtëpi të qytetit të Korçës, Ersekës, Devollit, Pogradecit, por edhe fshatrat hasen “qilimat me rrotë”, “me xhami”, “me dhisk me trëndafila”, “me simite” si dhe shkorsat, udhkat si dhe kuvertat me thekë. Velenxat dallohen për ngjyrat e ndezura, në veçanti përdorimi i të kuqes. Këto shtrohen në raste festash, gëzimesh dhe hidhërimesh.



Qëndisjet, tantellat, copat e thurura, mbulesat e krevatëve dhe qëndisje të tjera dekorative të bardha apo me ngjyra, të punuara me mjeshtëri artistike janë pjesë e çmuar e trashëgimisë së komunitetit të zonës. Qëndistaret zbukurorin krahas të tjerave edhe veshjet e burrave dhe të grave si këmisha, jelekë, përparje etj. Veglat e prodhimit artizanal si furka, druga, motovila, qerthulli, shtijat, tezgjahu ishin baza e artizanatit familjar. Ato ruhen ende kryesisht në fshatrat kulturore. Megjithatë, sektori i artizanatit në tërësi dhe i punimeve tekstile në veçanti nuk është edhe aq i

mirëorganizuar dhe nuk ekzistojnë shumë mundësi për turistët, për të blerë punimet e dorës karakteristike dhe tradicionale të zonës.

- **Vlerat e trashëgimisë kulturore shpirtërore**

Konventa për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale (UNESCO,2003) e përcakton trashëgiminë kulturore jomateriale (shpirtërore) si: “Praktikat, përfaqësimet, shprehjet, gjuhën, njohuritë, aftësitë si dhe instrumentet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore që lidhen me to, të cilat komunitetet, grupet dhe në disa raste individët i njohin si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore. Kjo trashëgimi shpirtërore e trasmetuar brez pas brezi është e rikrijuar në vazhdimësi nga komunitetet dhe grupet, në harmoni me mjediset dhe historinë e tyre dhe u jep atyre ndjenjën e identitetit dhe vazhdimësisë ashtu sikurse promovon respekt për diversitetin kulturor dhe krijimtarinë njerëzore. Kjo përfshin traditat gojore dhe shprehjet, gjuhën, artet performuese, praktikat sociale, ritualet, ngjarjet festive dhe punimet tradicionale”.

Shqipëria është e përfaqësuar në trashëgiminë kulturore botërore, krahas asaj materiale, edhe me trashëgiminë kulturore shpirtërore. Në vitin 2005 “Iso-polifonia popullore shqiptare shpallet “Kryevepër e Trashëgimisë Gojore të Njerëzimit”, e mbrojtur nga UNESCO. Ndonëse në kulturën shpirtërore të qarkut Korçë, nuk ka elementë të mirëfilltë të trashëgimisë shpirtërore të mbrojtur me statusin e trashëgimisë shpirtërore kombëtare, këtu gjejmë vlera të cilat janë trasmetuar brez pas brezi deri në ditët tona dhe kanë nevojë të vlerësohen dhe të mbrohen.

- *Folklori (këngët dhe vallet)*

“Kultura popullore e një kombi është një element i rëndësishëm, i cili bën të mundur përcaktimin e karakteristikave zakonore, gjuhësore të tij, e mëndësisë dhe prirjes për ruajtjen e identitetit si bashkësi e qëndrueshme historike, ekonomike e shoqërore”.

Vendodhja gjeografike, ekzistenca dhe prania e kulturës së hershme materiale, (veçanërisht etnografia e pasur), zhvillimi social ekonomik, shkëmbimet kulturore me zonat përreth, mund të cilësohen si faktorë që kanë ndikuar në formësimin e një identiteti dhe kulture shpirtërore të përbashkët. Nga ky këndvështrim trevat e qarkut të Korçës, së bashku me trevat e tjera në jug të Shkumbinit janë pjesë përbërëse e krahinës së toskërisë dhe e folmja e Korçës dhe krahinave të saj i përket nëndialektit të toskërishtes veriore të dialektit toskë. Gjuha e folkorit si themel i trashëgimisë shpirtërore të kombit tonë, në këtë hapësirë i ka qëndruar besnike gjuhës së folur popullore, duke ruajtur veçoritë e veta në kuadër të gjuhës letrare shqipe. Në qoftë se do të bënim një përjasje të shtrirjes së izoergeve (të dhënave etnografike) dhe izoglosave, në ekuivalentimit e këtyre arealeve, evidentohen areale të vogla që krahas ngjashmërive, kanë tipare të veçanta në të folmen e tyre si Strelca brenda krahinës së Gorës, fshatra në krahinën e Devollit, etj. Në të folmen e Korçës, Kolonjës dhe Pogradecit, për të gjitha kategoritë e foljeve më të përhapura janë format “-nja”, “-nje”, “-te” për vetat e njëjësit: qepnja, qepnje, qepte. Ndërkohë që në të folmen e Devollit folja e zgjedhimit të tretë shoqërohet me bashtingëlloren “nj” si mbaresë: lironj, dëgjonj, kallëzonj, gdhinj, thyenj, etj. Po kështu karakteristikë është edhe përdorimi i ndajfoljeve dhe parafjalëve: këtuckë (këtu), njëdizaj (një ditë), javash (avash), tashti, prëmë, ndënë, gjende (përsëri) etj.

Ndërkohë që përdoren shprehjet: ardhmë de Korçë (në), dë mëngjes (në), pe asaj që thua ti (prej), de vinj (po vij), etj.

➤ *Këngët folkloristike* lindin njëherësh si tekst dhe si melodi duke përbërë një unitet, të cilat kur ekzekutohen bashkarisht trasmetojnë një forcë estetike dhe emocionale të këngës.

➤ *Muzika popullore qytetare korçare* dhe e rrethinave bën pjesë në isopolifoninë toske dhe është pjesë e iso-polifonisë shqiptare. Kjo muzikë arriti kulmin e saj në gjysmën e dytë të shekullit të XX, ku spikatën folklori vokal, instrumental dhe koreografik. Veglat muzikore shoqëruese të muzikës popullore janë sazeja, klarineta, firzamonika, lahuta, violina dhe dajreja. Këngët i këndohen kryesisht punës dhe dashurisë. Ato përfshijnë këngët e dasmave, këngë të burrave, këngë të grave, këngë të fshati dhe të qytetit. Shumica e këngëve popullore janë polifonike për nga natyra dhe karakterizohen nga i kënduari me zë melodios dhe shprehës. Përveç, Korçës dhe Devollit, Leskoviku ka qenë qendra kryesore e zhvillimit të sazeve dhe muzikës me saze në gjithë Shqipërinë e Jugut.

➤ *Serenata korçare* me kitarën dhe mandolinën, i ka fillimet e saj në gjysmën e dytë të shek.XIX dhe përbën një pasuri me vlera për gjithë muzikën qytetare.

Ajo ka kultivuar një kulturë të re, një moral të ri qytetar, një etikë të re të ndjenjave intime; ajo hapi dyert e emancipimit shoqëror e afrimit me botën e qytetëruar europiane. Ky simbol kulturor shpirtëror këndohet sot jo vetëm në Korçë por në gjithë Shqipërinë. Në qershor të vitit 1928 u formua shoqëria “Lyra”, e cila në bazë të saj kishte dy formacione muzikore: korin dhe orkestrën. Në qoftë se do ta quanim trashëgimi shpirtërore, *korin Lira*, do të thoshim trashëgimi shpirtërore me këngëtarë që këndojnë prej katër brezash.



“Kori Lira”, numëron në gjithë repertorin e tij mbi 200 këngë patriotike, lirike e satirike, të cilat interpretohen brenda dhe jashtë vendit. Disa nga këngët e njohura si: “Këto shkronja janë të arta ne i duamë”, “Sot lipset me flamurë malit të dalimë”, “o Trima luftëtarë, ju bijtë e Skëndërbeut, kërkoni, ju shqiptarë lirinë e mëmëdheut”, “Duam më shumë Shqipërinë, që t’i vejë puna mbarë e përjetë ta ketë lirinë”, janë krenaria dhe pasuria jo vetëm e një treve apo komuniteti, por e gjithë vendit dhe kombit.

Serenada Korçare dhe Kori Lira janë pjesë e trashëgimisë kulturore shpirtërore me vlera lokale, rajonale dhe kombëtare, prandaj meritojnë të vlerësohen dhe mbrohen me statusin “Kryevepër e Trashëgimisë Shpirtërore Kombëtare”, krahas Eposit të Kreshnikëve, Ahengut Shkodran etj



➤ *Vallet* janë fusha e ndërthurja së muzikës me koreografinë popullore. Secila nga krahinat e hapësirës së studimit, përfaqësohet me muzikën dhe vallen e vet që e karakterizon. Vallet luhen me trup, me këmbë, duar dhe me shprehjen e fytyrës sipas karakterit të saj. Vallet luhen nga gratë dhe nga burrat, por ato mund luhen edhe vetëm nga gratë ose vetëm nga burrat sipas llojit të tyre. Në trevat e Korçës gjejmë të mishëruara vallet lirike të dashurisë, dasmave dhe vallet epike të burrave. Përmenden vallja leskoviçare, vallja devolliçe e burrave, vallja kolonjare e grave, vallja dardha e vajzave etj. Interpretimi i tyre në rastet e festave dhe eventeve, me kostumet popullore të trevave përkatëse, nxjerr më së miri në pah vlerat e tyre artistike dhe plotëson tërësisht ofertën turistike kulturore.

➤ **Festat dhe frekuentimi turistik**

Festat janë elementi më popullor i atraksioneve shpirtërore dhe zakonisht janë në formën e festimeve apo të ngjarjeve historike, që banorët lokalë dëshirojnë t'i ndajnë me komunitetin e zonës në tërësi dhe me vizitorët, qofshin vendas apo të huaj. Nisur edhe nga traditat në këtë gjini të trashëgimisë, qarku i Korçës po gëzon një reputacion si rajoni i festivaleve dhe i ngjarjeve – veçanërisht qyteti i Korçës i njohur ndryshe edhe si “Qyteti i Festave”.

Disa nga festimet e trashëguara, përfaqësojnë traditat e hershme në kulturën e zonës,

të cilat e identifikojnë dhe dallojnë nga zonat e tjera të Shqipërisë, por edhe të rajonit. Njëpërmjet tyre komuniteti promovon vlerat e trashëguara shpirtërore dhe njëkohësisht siguron vazhdimësinë e trasmetimit të tyre për brezat e ardhshëm. E veçanta e gjithë qarkut qëndron në praninë e festimeve të shumta fetare (religjioze), çka mund të shërbejë si një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit religjioz. Pjesëmarrja në ditët e organizimit të festave është e larmishme, ku krahas banorëve vendas edhe vizitorëve nga vende të tjera të Shqipërisë, është ngjallur interesi i vizitorëve të huaj që vizitojnë Shqipërinë në këtë periudhë. Pavarësisht përmasave të këtyre eventeve dhe festimeve, ndër më të rëndësishmet për nga impakti social-ekonomik që ato kanë, do të përmendim:

- *Festa e Karnavaleve* (28-29 Maj), me paraqitje teatrale dhe muzikore, e zhvilluar që

para viteve '40, është kthyer tashmë në një traditë të përvitshme festimi në qytetin e Korçës. Përfshirja në të e grupeve nga Shqipëria, Maqedonia, Italia, Mali i Zi dhe Greqia, me trupat e tyre të zbukuruara me ngjyra të larmishme, maska dhe kapele, e bëjnë të larmishme performancën, në rrugët e qytetit në prani të mijëra banorëve dhe vizitorëve të ardhur për këtë event. Rreth 20.000 vizitorë (e përlllogaritur nga bashkia) ishte numri i pjesëmarrësve në këtë festë në vitin 2012. Në vazhdimësi të traditës së tyre, karnavalet festohen me origjinalitetin e tyre, njëkohësisht edhe në fshatin Polenë në prani të qindra vizitorëve.

- *Festa e Birrës*, (14-18 Gusht) që prej vitit 2007 është kthyer në një traditë të përvitshme të organizimit të eventeve në sezonin turistik të verës. Festa përbën eventin me impaktin më të madh social, ekonomik dhe kulturor në qarkun e Korçës. Gjatë ditëve festive sipas të dhënave të bashkisë, qyteti vizitohet nga dhjetëra mijëra (60-80 000) vizitorë jo vetëm nga Shqipëria por edhe vizitorë të huaj nga rajoni dhe bota. Në vlerësim të promovimit të vlerave kulturore, në vitin 2010.

Festa e birrës u nderua me çmimin e “Turizmit Shqiptar 2010”, akorduar nga Ministria e Turizmit, Rinisë dhe Sporteve. Në këtë event së bashku me “Birra Korça” dhe firmat e tjera të produkteve të zonës marrin pjesë edhe marka të tjera produktesh, të cilat përveç shitjeve promovojnë edhe produktet e tyre. Në vitin 2013, festa u organizua për pesë ditë me radhë dhe e drejta e promovimit ju dha gjithashtu, një firme nga Serbia.

- *Festa e lakrorit*, (7 shtator) mbështetur në traditën e një prej produkteve të gatimit tradicional të zonës, është kthyer në një organizim të përvitshëm të tërheqjes së vizitorëve në qytetin e Korçës. Duke respektuar gjithashtu traditën e “amvisave”, një grup grash korçare në mënyrë të organizuar përgatisin në natyrë lakrorë (piqen në saç) me gjellë të ndryshme, të cilët porositen dhe u serviren vizitorëve kundrejt pagesës.

- *Panairi i poçerisë* organizohet në qendër të qytetit të Korçës, gjatë gjithë javës së Pashkës Ortodokse. Panairi lidhet me traditën e vjetër të punimit të baltës si edhe traditën e hershme të besimtarëve ortodoksë për “blerjen e baltës” gjatë javës së pashkës, veçanërisht ditën e premtë të ashtëquajtur “e premtja e zezë”. Artizanë dhe tregtarë të ndryshëm jo vetëm të zonës, ekspozojnë dhe tregetojnë produktet e tyre, që blihen jo vetëm nga besimtarët por edhe vizitorët e tjerë.

- *Festa e liqenit, dhe festa e verës* (dhjetor) në qytetin e Pogradecit janë shndërruar në tradita të festimeve që shoqërohen më pjesëmarrjen e një numri të madh

vizitorësh nga Shqipëria dhe rajoni. Festa shoqërohet me panairë të produkteve tradicionale të gjithë zonës së Pogradecit.

Festivali Folklorik i Prespës (11 Tetori) dhe Java verore kulturore e Prespës (02-10 Gusht), Dita e Verës në Prespë (Dhjetor), janë festa të organizuara nga minoriteti maqedonas në komunën e Liqenasit që mbledhin në këto ditë mijëra vizitorë.

Atmosfera festive shoqërohet me shprehjen e traditave, zakoneve dhe promovimin e produkteve origjinale të komunitetit maqedonas.

Krahas festave pagane qarku i Korçës dallohet dhe për numrin e madh të festave fetare, sidomos atyre të krishtera.

Disa nga këto festa janë: Festa e Shën Prodhomit më 24 Qershor, në Voskopojë; Festa e Shën Mërisë më 15 Gusht, në Boboshticë dhe në Voskopojë; Festa e Shën Mërisë më 16 Gusht, në fshatin Dardhë; Festa e Satrivaçit më 1 Korrik, në fshatin Hoçisht të rrethit Devoll; Festa e Ristozit dyzetë ditë pas pashkëve, në Mborje të Korçës; Festa e Shën Thanasit më 18 Janar, në qytetin e Korçës; Festa e Shën Gjergjit në Dardhë, pas festimit të pashkës sipas kalendarit ortodoks; Festa e Shën Pjetrit në Vithkuq; Festa e Pashkëve në qytetin e Korçës, sipas kalendarit ortodoks; Festa e Krishtlindjeve më 25 Dhjetor.

- *Dita e verës* festohet në 1 Mars, për besimtarët ortodoksë dhe 14 Mars për besimtarët myslimanë. Ndezja e zjarreve, veroret dyngjyrëshe (kuqe dhe të bardhë), përgatitja e

kulaçit me sheqer, fiqtë e thatë, vera e kuqe, vezët e kuqe (për besimin mysliman), degët e këputura me sythet e porsaçelura, janë elementë që shoqërojnë këtë festë.

➤ *Rosicat* është festë e besimtarëve ortodoksë tradicionale për fshatin Boboshticë. Festohet ditën e tretë pas fluturimit në qiell të Krishtit, “kur Shën Maria thirri shoqet dhe gatuan një drekë për të festuar”. Gratë e fshatit të vjetra dhe të reja, të veshura me kostumet tradicionale të zonës, pasi kanë kryer ritet fetare në kishën e Shën Mërisë, nisen drejt rrugicave të fshatit. Me këngë në gojë dhe me kërcime ato trokasin shtëpi më shtëpi duke uruar shëndet dhe mbarësi si dhe duke mbledhur ushqime (miell, vezë, gjalpë, sheqer), me të cilat përgatisin një drekë të madhe ku do të ftojnë gjithë fshatin dhe vizitorët. Është festë sa e krishterë aq edhe pagane, sepse lidhet edhe me ardhjen e verës, çeljen e luleve dhe gatuhet vetëm brumë, pasi fshati e ka jetën të lidhur me grurin dhe blegtorinë.

Nisur nga numri i madh i produktit kulturor, në qarkun e Korçës organizohen disa festivale apo konkurse, siç janë: *Festivali i Ushqimit* organizohet gjatë sezonit turistik të verës (Qershor-Shtator). Çdo ditë të mërkurë hahet ushqim tradicional i mirë dhe më çmim të lirë në restorantet dhe tavernat që janë pjesë e këtij eventi; *Konkursi Ndërkombëtar i Fotografisë “Sotir”*, organizohet për nder të fotografit të madh korçar Kristaq Sotir dhe traditës së fotografisë së ndërtuar prej tij. Konkursi mbledh në qytetin e Korçës fotografë nga vende të ndryshme të botës të cilët ekspozojnë dhe konkurojnë me punimet e tyre që ekspozohen në galerinë “Guri Madhi”; Kolonia Ndërkombëtare e Piktorëve “Ditët e Mios”, zhvillohet çdo vit në qytetin e Korçës nën emrin e piktorit të madh Vangjush Mio. Prania e piktorëve nga Shqipëria dhe vende të tjera jashtë saj vendos jo vetëm lidhje të komunikimit midis artistëve, por njëkohësisht promovon dhe vlerat e qytetit dhe gjithë qarkut të Korçës; Panairi i fundvitit përbën një lloj festimi në ditët e fundit të vitit, i shoqëruar me panair të produkteve të zonës.

Simpoziumi Ndërkombëtar “Skulptura e Parkut” është një event në kuadër të traditës së hershme të punimit të gurit dhe mirëpret çdo vit në qytetin e Korçës, skulptorë nga vende të ndryshme të botës të cilët marrin pjesë me skulpturat e tyre si simbolikë për qytetin.

➤ **Traditat**

Trashëgimia shpirtërore është e pasur edhe me tradita dhe zakone, rite dhe ceremoni që kanë të bëjnë me lindjet, martesat dhe vdekjet. Një aspekt të rëndësishëm kulturor, përbën mënyra e jetesës brenda dhe jashtë ambientit të banimit. Mobilimi i banesës dallohet në fshat dhe në qytet, për orendi të veçanta, sipas funksioneve që kryenin mjediset përkatëse të banimit. “Oda e miqve”, dallohet për përdorimin e elementëve tradicionalë të zbukurimit, si sixhadet, velencat që mbulonin minderët, jastëkët, mobiljet e vjetëra, në disa raste të sjella nga vendet fqinje, enë metalesh të zbukuruara, porcelane dhe tantella e mbulesa të punuara me dorë. Disa prej këtyre elementeve i gjejmë edhe sot të ruajtura në banesën dhe mënyrën e jetesës së qytetit. E krahasuar me të njëjtin ambient të banesave të qytetit të Gjirokastrës, Beratit dhe Shkodrës, në këto të fundit elementët dekorues janë më të pasur në orendi dhe në ngjyra. Karakteristike këtu janë gdhëndjet dhe daltimet e shumta të drurit në tavane si edhe dekorimi i oxhakëve, madje këta të fundit ndryshojnë edhe nga forma. Një nga traditat që vlen për t’u përmendur janë *mikpritja dhe qytetaria korçare*. Të vlerësuara pozitivisht në opinionet e turistëve të huaj, mund të themi se janë dy pika të forta të tërheqjes turistike në qarkun e Korçës.

➤ **Zejtari e ndryshme tradicionale**

Artizanati dhe zejet tradicionale janë gjithashtu pjesë e trashëgimisë shpirtërore kombëtare shqiptare. Ato dëshmojnë për botën dhe krijimtarinë e pasur shpirtërore të komunitetit i cili i ka krijuar, i ka ruajtur me dashuri dhe krenari dhe përpiqet t’i trasmetojë ato në brezat e ardhshëm. Voskopoja dallohet për prodhimin e shajakut për eksport, Dardha për punimin e drurit, Bradvica për punimin e enëve prej balte, Progrid për ndërtimin e banesave dhe Opari për punimin e gurit e për shtrimin me kalldrëm etj. *Veglat e punës* kanë qënë të shumëllojshme në varësi të natyrës së punës. Pothuajse në të gjithë zonën rurale përdoren të njëjtat vegla të ndërtuara kryesisht prej druri dhe metali. Parmenda ishte mjete kryesor që lëronte tokën, ndërkohë që përdoren edhe mjete të tjera si shati, kazma, lopata, qylyku, piroi, kosa etj. Tashmë ato ruhen si sende relike në banesat rurale.

Veglat muzikore përbëjnë një zeje të veçantë në pamjen e përgjithshme të zejtarisë shqiptare. Në rrugë artizanale kanë qënë prodhuar dhe ende prodhohen vegla si gajde, fyelli, dajre, lauri, buzuk, mandolinë, etj. *Fyelli* është vegël e përdorur nga barinjët në të gjithë Shqipërinë. Ka gjetur përdorim të gjerë në të gjithë zonën malore të Korçës. Ai është i ndërtuar nga një gyp druri apo dhe metali me vrima për të krijuar melodinë. *Klarineta* është një instrument si klarineta që përdoret në ditët e sotme dhe një nga instrumentat më të rëndësishëm të muzikës popullore. *Buzuku* është një lloj mandoline me 6-10 tela të cilës i bihet me pendë 220. Është i përhapur në trevat e zonës së Korçës dhe Leskovikut. *Gajdja* është e ndërtuar me lëkurë keci, qengji etj. që mbushet me

ajër. Ka një tytë druri për t'a fryrë, një tytë tjetër me vrima që lëvizin gishtat dhe një të tretë pa vrima që shërben për të krijuar ison.²²¹ Luhet në zonën e Pogradecit, Korçës dhe Kolonjës. *Lahuta* përbëhet prej druri, me bisht të gjatë dhe me tela. Ka qenë mjaft e përhapur në trevën e Korçës dhe vazhdon edhe sot të jetë pjesë e sazeve të muzikës popullore. Po kështu kitara është e ndërtuar prej druri dhe është instrument i përhapur në të gjitha zonat e qarkut të Korçës. Ajo përbën simbolin e këngës qytetare korçare dhe është pjesë e trashëgimisë së saj.



➤ **Kuzhina tradicionale dhe frekuentimi turistik**

Gastronomia gjithashtu, është pjesë e trashëgimisë kulturore dhe shumë pak njerëz mund ta pranojnë si të tillë. Gastronomia franceze, meksikane, mesdhetare janë pranuar tashmë si trashëgimi kulturore botërore. Si pjesë e jetës dhe traditave sociale ajo konsiderohet si resurs dhe element vital i gjithë komponentëve turistikë. Në pothuajse çdo destinacion, sot shërbimi i ushqimit është i rëndësishëm po aq sa akomodimi. Është një pritshmëri e përgjithshme për pjesën më të madhe të turistëve të kenë mundësi të provojnë gatimet tradicionale të kuzhinës locale. Pa dyshim që trashëgimia kulturore e qarkut të Korçës nuk do të mund të kuptohej pa gastronominë e veçantë dhe të shumëllojshme. Si pjesë e traditës mbarë shqiptare në fushën e trashëgimisë kulturore ajo është e lidhur ngushtë me elementët etnografik, traditat, zakonet dhe mjedisin karakteristik të vetë zonës. Përgatitja e zahireve është traditë e hershme e gjithë trevës së Korçës, fshatit dhe qytetit. Zgjatja e periudhës së dimrit shtron domosdoshmërinë e grumbullimit të ushqimeve dhe përgatitjes së tyre,

që në fund të stinës së verës dhe fillimit të vjeshtës. Në këtë periudhë përgatiten petkat, trahani i ëmbël dhe i thartë, oshafkat, reçelrat, turshitë nga më të thjeshtat deri tek të mbushurat. Nga fundi i vjeshtës përgatitet *pastërmaja, llukanikët e kollofacet*. Nxjerrja e verës dhe rakisë shoqëron përgatitjen e zahireve, të cilat ruhen në ambjente të posaçme (bodrome apo qilare) të shtëpive private të fshatit por edhe qytetit. Guzhina tradicionale pëlqehet dhe preferohet në të gjithë vendin për freskinë dhe cilësitë e veta organike. Çdo trevë e qarkut përmendet për specialitetin dhe llojshmërinë e gatimeve.

Qyteti i Pogradecit si edhe fshatrat e pozicionura përgjatë liqenit të Ohrit si Tushemishti, Pojska, Lini ofrojnë gatimin e *peshkut të koranit, troftës, belushkës, ngjalës* etj. Në fshatrat e liqenit të Prespës gatuhet tava tradicionale e krapit, si dhe lloje të tjerë peshqish si mërena, cironkat të njoma dhe të thata. Këto shoqërohen me turshitë me gjizë dhe llojin e veçantë të byrekut. Prania e varieteteve tradicionale të rrushit (vranec, smederefka) është e lidhur ngushtë me prodhimin e verës, që përbën një produkt origjinal të zonës .

Në Voskopojë mjedisi gërshetohet me gatimet tradicionale, si një nga produktet lokale të frekuentura nga turistët. Ofrohet *mishi i qengjit në hell, i veçantë në shijen e tij, lakrorët në saç, turshitë dhe rakia e kumbullës*.

Fshati i Dardhës dallohet për specialitetin e tij, *lakrorin me dy petë në saç, i përgatitur me gjellë të ndryshme*. Veç kësaj përmenden piperkat me gjizë, gatimi e ligavecëve (kërmijëve) dhe rakia e kumbullës së Dardhës.

Boboshtica është një fshat që dallohet në tërësi për gatime tradicionale të mishit dhe të brumërave. Veçanërisht e spikatur është nxjerrja e rakisë së manit me vlera të shëndetshme, traditë e favorizuar edhe nga prania e drurëve të manit.

Treva e Kolonjës përmendet për rritjen natyrale të gjedhit dhe të dhenve, produktet e mishit të të cilëve janë të pëlqyera dhe të kërkueshme nga konsumatorët. Përmendim gjithashtu verën e Leskovikut e cila nxirret në punishte tradicionale, duke mos i humbur vlerat ushqyese.

Megjithëse këto gatime nuk përgatiten në mënyrë të veçantë për turistët, ato përbëjnë një produkt turistik të kërkuar dhe mjaft të pëlqyer.